

Me një vendim që përmbante vetëm tre paragrafë të shkurtër, Gjykata e Lartë i dha pafajësinë Ilir Metës, duke zbuluar ndoshta atë çka pritej, por lënë pa zbardhur vetëm argumentimin e tij.

Në seancën e 21-të të procesit gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë në ngarkim të ish-zëvendëskryeministrit Ilir Meta, Kolegji Penal shpalli pafajesine për të me 4 vota pro dhe një votë paralele.

Edhe pse vendimi ishte caktuar të deklarohet në orën 13, Kolegji Penal hyri në sallë dy orë e gjysmë vonesë. Relatori i çështjes Ardian Dvorani deklaroi se Ilir Meta, nën akuzë për korrupsion aktiv të funksionareve të lartë shtetërore shpallet i

pafajshëm për akuzën që i adresohet, atë të korrupsionit aktiv, si të paprovuar. Me tej relatori Dvorani u shpreh se ai ka mendim paralel, çka do të thotë se edhe ai ka qenë pro pafajësisë së Metës, por të arsyetuar ndryshe.

Brenda 15 ditësh pritet që Gjykata e Lartë të zbardhë arsyetimin e vendimit, ndërkohë që provat materiale do t'i shkojnë prokurorise për një tjetër procedim penal.

Përfaqësuesi ligjor në LSI, Spartak Braho deklaroi pas shpalljes së vendimit se "Gjykata foli, të tjerët të heshtin. Pas vendimit të gjykatës kjo çështje nuk ka më histori"

Prokurori paraqiti më datë 6 janar pretendencën duke kërkuar shpalljen fajtor të Ilir Metës.

Prokuroria në konkluzionet e saj përfundimtare kerkoi të deklarohet fajtor i pandehuri i saj Ilir Meta, për akuzën e [korrupsionit aktiv të funksionareve të lartë shtetërore](#) dhe të denohet, sipas prokurorit Bujar Sheshi, me dy vjet burgim dhe një milion leke gjobe,

Prokurori iu referua deshmisë së njeriut kyç në këtë çështje ish-ministrit të Ekonomisë, Dritan Prifti duke ritreguar edhe njëherë deklaratimet e Priftit, kur tha në gjykatë se kishte presion nga Meta, i cili i kerkonte shpesh, sipas tij favore për ankande dhe koncensione.